

KONTRATE DHURIMI KUOTE

Ne Tirane, sot me 30/01/2019 (dymije e nentembedhjete) me vullnetin e lire e te plote hartohet kontrata e dhurimit ndermjet paleve:

z. Mond BEGA, atesia Irfan, lindur me 31.12.1970 ne Lushnje dhe banues ne Tirane, i identifikuar me Pashaporte me nr personal H01231017D, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, **me poshte i quajtur Dhuruesi**

dhe

z. Benard Velo, atesia Memiko, shtetas shqiptar, lindur me 06/07/1991 ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nga leternjoftimi me NID J10706061T, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, **me poshte i quajtur Pranuesi i dhurimit**

Meqenese ekzistojne faktet:

Z. Mond Bega eshte ortak ne Shoqerine "Beton Express 2018" shpk dhe zoterues i nje kuote me vlere 8'000 Leke, qe perben 80 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise Beton Express 2018 shpk, e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, e identifikuar me NIPT L82128001N dhe me seli ne adresen 'Tirane Petrele-Mullet, ne te djathte te rruges Nacionale Tirane - Elbasan, km.11, ZK.1977.

z. Mond Bega me vullnetin e lire e te plote deklaroi shprehimisht se do ta dhuroje kuoten qe zoteron ne favor te z. Benard Velo, i cili eshte edhe ortak i shoqerise Beton Express 2018 shpk, mbajtes i nje kuote me vlere 2'000 Leke, e cila perben 20% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

z. Benard Velo me vullnetin e lire e te plote deklaroi shprehimisht se pranon dhurimin e kuotes qe Mond Bega transferon ne favor te tij me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhim prej saj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve te shoqerise Beton Express 2018 shpk nepermjet vendimit Nr. 2 te dates 30/01/2019 nder te tjera ka vendosur Miratimin e dhurimit te kuotes se zotuar nga Mond Bega ne favor te Benard Velo.

Palet e mesiperme me vullnetin e lire e te plote hartojne kete kontrate dhurimi kuote me permbajtje si me poshte:

Neni 1
Qellimi i kontrates

Qellimi i kesaj kontrate eshte transferimi teresisht i pronesise se kuotes se zoteruar nga dhuruesi tek pranuesi i dhurimit.

Kjo kontrate sherben per percaktimin e kritereve, procedurave dhe menyren e tranferimit te pronesise se kuotes objekt i kesaj kontrate.

Ne percaktimin e kushteve palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 2
Objekti i kontrates

Nepermjet kesaj kontrate dhuruesi tranferon pa shperblim ne favor te pranuesit te dhurimit z. Benard Velo kuoten qe zoteron ne shoqeri, me vlere 8' 000 Leke, qe perben 80% te kapitalit te shoqerise.

Gjithashtu pranuesi i dhurimit z. Benard Velo deklaron shprehimisht se eshte plotesisht dakort dhe pranon dhurimin e kuotes nga z. Mond Bega.

Neni 3
Pergjegjesi dhe garanci te paleve

Dhuruesi i kuotes nepermjet kesaj kontrate dhurimi kuote garanton pranuesin e dhurimit si me poshte:

- a) Se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes qe po transferon,
- b) Se kuota objekt dhurimi eshte e lire nga cdo barre, detyrim apo cdo lloj kufizimi tjeter,
- c) Se dhurimi i kuotes eshte ne perputhje te plote me dispozitat statutore te shoqerise dhe ligjin tregtar ne fuqi,
- d) Se kontributi monetar i derdhur prej tij per blerjen e kuotes ben pjese ne pasurine vetjake te tij.

Neni 4
Heqje dore nga te drejtat

Dhuruesi deklaron nen pergjegjesine e tij personale se me nenshkrimin e kesaj kontrate ai heq dore nga te gjitha te drejtat qe i kane takuar ne cilesine e ortakut ne shoqeri apo cdo e drejte tjeter pa kufizim.



Neni 5
Efektet e kontrates

Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimit te saj.
Kontrata ka efekt kundrejt te treteve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 6
Tranferimi i te drejtave

Pas nenshkrimit te paleve kontrata do te depozitohet dhe regjistrohet ne QKB.
Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhuruesi i kuotes zhvishet teresisht nga pronesia mbi kuoten qe zoteronte ne shoqeri si dhe nga cdo e drejte tjeter mbi kete kuote dhe zoteruesi i ligjshem i saj behet Benard Velo.

Neni 7
Ligji i aplikueshem dhe gjykata kompetente


Kontrata eshte hartuar ne perputhje te plote me legjislacionin civil e tregtar ne fuqi.
Ne rast mosmarreveshje dhuruesi dhe pranuesi i kuotes angazhohen te bejne cdo perpjekje per zgjidhjen e saj me mirekuptim, ne te kundert ceshtja do ti nenshtrohet juridiksionit gjyqesor, Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

Neni 8
Dispozita perfundimtare

Kjo kontrate dhurimi u hartua ne gjuhen shqipe, ne dy kopje me vlere te njejte juridike, nje per secilen pale.
Palet deklarojne se e lexuan kontraten, e kuptuan permbajtjen dhe e neshkruajne personalisht pa verejte me vullnet te lire e te plote.

DHURUESI

MOND BEGA

Mond Bega


PRANUESI I DHURIMIT

BENARD VELO

Benard Velo
